



Jo, ti nuk je fajtore



"Dhunë ndaj gruas është ç'do akt dhune, i krijuar në gjininë që rezulton ose mund të rezulton në lëndimet fizike, seksuale ose psiqike, n ë vuajtjet e grave duke i kyçur edhe kërcënimet për sjelljet e këtilla."

Definicion për dhunën ndaj grave kanë dhënë Kombet e Bashkuara (e përfshirë në Deklaratën për eliminimin e dhunës ndaj grave –Rezoluta 48/104 e kuvendit gjeneral 20.12.1993).



Dhuna psiqike qëndron në sulmet e përhershme verbale, shqetësimet ë bezdisshme, shprehjet posesive, izolimi i gruas nga miqtë dhe familja më e ngushtë, e privuar (e lënë pa asgjë) pa mjete fizike dhe ekonomike si dhe eliminimi i pasurisë personale.



Dhuna fizike ose sulmet fizike apo sjelljet agresive të dhunuesit (tiranit) mund të jenë: një gërvishtje, një vrasje etj. E tërë kjo fillon me diçka që në shikim të parë të duket si kontakt fizik jo aq i rëndësishëm, por më vonë rritet në atak shumë serioz.



Dhunën fizike e përbëjnë kërcenimet fizike ose ç'do kërcenim tjetër si psh. gjuajtje me ndonjë send që mund të lëndon rëndë, rrahje, shtyerje apo rrokje me dorë (rrëmbim) ose përdredhja e dorës apo ndukja e flokëve, shuplakat, shkermimi, grithja apo rrahja me shkop, tentim për gulfatje, mbyllja e gojës, rrahja me ndonjë send djegje ose përvëlim me ujë, përdorimi i thikës ose revoles etj.



Keqpërdorimi seksual në të shumtën e rasteve është një element dhune ose kulmi i sulmeve fizike të atij që ushtron dhunë. Gruaja detyrohet të ketë marëdhënie seksuale me dhunuesin ose detyrohet të mer pjesë në një aktivitet të pa dëshirueshëm.



**MIT:** Një numër i vogël grash janë viktima të dhunës familjare.

**REALITET:** Sipas disa hulumtimeve të realizuara në Maqedoni në vitin 2000

- 61,5 përqind nga të anketuarat u deklaruan se kanë qenë viktima të ndonjë lloj forme të dhunës psiqike.
- nga 23,9 përqind të atyre që i kanë anketuar, kanë deklaruar se kanë qenë viktima të dhunës fizike.
- 5,0 përqind të të anketuarëve kanë deklaruar se kanë qenë viktima të dhunës seksuale.



**MIT:**Grave ju pëlqen të keqtrajtohen .

**REALITET:**Viktimat e dhunës familjare duke u lutur kërkojnë që dhuna të ndërpritet. Ato gjithmonë mundohen të bëjnë strategji të ndryshme që të mbijetojnë, thirrin policinë kërkojnë ndihmë nga familja më e ngushtë që ta shpëtojnë veten dhe fëmijët e tyre.



**MIT:** Gruaja mund të ik kur dëshiron dhe nëse dëshiron

**REALITET:** Përgjigja më e shpeshtë e dhunës familjare "Përse ajo nuk shkon(ik)" nuk e mer parasysh pozitën e saj reale ekonomike dhe sociale. E ballafaquar me harxhime për qira, çerdhe, shkollim, sigurim shëndetsor dhe për harxhime tjera të nevojshme, gruaja e parandjen se nuk mundet vet ta përballon egzitencën e saj dhe të fëmijëve.



**Mesazhe:**

**Dhunuesit:**

- Dhuna familjare është vepër kriminale;
- Dhuna familjare do të shkatërron jetën tënde dhe të partnerit (viktimës) tënd;
- Mund të gjeni ndihmë që e tërë kjo situatë e krijuar të merr fund.

**PYET MOS PARAGJYKO!**



**Mesazhe:**

**Viktima:**

- Thyej murin e heshtjes që e ka rrrethuar familjen e dhunuar;
- Mos e tolero dhunën;
- Ndihma egziston!

**TI NUK KE BËRË FAJ!**



**Mesazhe:**

**Dëshmitarët në dhunën familjare:**

- Ndihamoni gratë viktima të dhunës ,ndërprejeni heshtjen;
- Ndihamoni që të mos viktimidohen më tutje!



"Familja është strehë; parajsë shumë larg egërsimeve të panevojshme. Familja është bota reale ku gjejmë miqësi, përkujdesje në marrëdhëniet tona intime me të afërmit tanë. Qëndrimet tona esenciale formohen në kontekst të familjes."

Radhika Coomaraswamy  
Raportuesi special për dhunën ndaj grave në Kombet e Bashkuara .

### **Partneri yt:**

- Sillet si mbrojtësi yt apo është tip xheloz?
- Të ofendon apo të kritikon pra të tjerëve?
- Të detyron të ndjehesh se nuk ke të drejtë, se je e çmendur dhe e paaftë?
- Ndonjëherë ka vozitur shumë shpejt me qëllim që të mbjell frikë në shpirtin tënd?
- Ta ndalon afrimin (shkuarjen) deri te llogaria e bankës dhe karteles për kredit, ose i kontrollon ai vet të gjitha të ardhurat dhe të detyron të japësh llogari për gjithçka që harxon?
- Ta ndalon të shkosh atje ku dëshiron, kur dëshiron dhe me kë dëshiron?
- Të rreh, të bie me shuplakë, të shkelmon, të shtyn, të gulfat apo të kafshon?
- Ndonjëherë të detyron me zorr të kesh kontakt seksual?
- Kërkon falje pasi të dhunon duke e përsëritur se kjo nuk do të ndodh më kurrë?
- Gjen shumë arsyë për sjelljen e tij të dhunshme?
- Të fajëson ti për sjelljen e tij të dhunshme?
- A e veneron sjelljen morbide të partnerit me qëllim që t'i ikish situatës së keqësuar?
- Ndjehesh pa kurrfarë përkrahje, e zënë në kurth, e vetmuar dhe nën kontrollin total të partnerit?
- A e ndjen veten fajtore për dhunën që ushtrohet mbi ty?
- A trembesh t'i kundërvehesh partnerit?



Qendra për ndihmë juridike  
Kontakt telefoni:  
Shkup 02 311 78 66  
Shtip 032 391 991  
Tetovë 044 343 410

Shoqata për emancipim ,solidaritet dhe barazi gjinore në R.M.  
Ruga Maksim Gorki 20 1/4  
1000 SHKUP  
tel. ++389 (0)2 3298 295; 3298 296  
faks ++389 (0)2 3211 453  
[www.esem.org.mk](http://www.esem.org.mk)  
[esem@unet.com.mk](mailto:esem@unet.com.mk)

